

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE PREZANTON NË KUVEND RAPORTIN E VITIT 2025 DHE PRIORITETET STRATEGJIKE NË VIJIM



SFIDA JONË ËSHTË TË NDËRTOJMË BESIM; QË QYTETARI TË NDIHET I MBROJTUR, QË INVESTITORI TË NDIHET I INFORMUAR DHE I TRAJTUAR DREJT, QË EKONOMIA TË KETË MË SHUMË ALTERNATIVA FINANCIMI DHE INVESTITORI MË SHUMË MUNDËSI ZGJEDHJEJE, DHE MBI TË GJITHA, BESIM TEK INSTITUCIONET QË GARANTOJNË INTEGRITET DHE RREGULLA TREGU."

Adela Xhemali

Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive
Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare



> Lexo më shumë...

NË FOKUS :

- AMF prezanton në Kuvend raportin e vitit 2025 dhe prioritetet strategjike në vijim
- Zhvillohet Forumi Ndërkombëtar mbi Rrezikun e Katastrofave Natyrore
- Vështrim mbi tregjet nën mbikëqyrje
- Autoriteti mbledh Grupin Ndërinstitucional për avancimin e Kapitullit 9 të Integritimit Evropian
- Takim me shoqëritë e sigurimit për përgatitjen e tregut drejt regjimit Solvency II

VITI 2025 – TREGJET NËN MBIKËQYRJEN E AMF-SË

1. Tregje financiare në rritje dhe të qëndrueshme.
2. Vlera totale e aktiveve të tregjeve nën mbikëqyrje – rreth 149 miliardë lekë, me rritje re prej 13% krahasuar me vitin 2024.
3. Veprimtaria mbikëqyrëse e orientuar drejt riskut, transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.
4. Avancim veçanërisht në drejtim të Solvency II, SNRF 17, Faktorëve të Riskut në llogaritjen e primeve të TPL.
5. Agjenda jonë në vijim:
 - i. Përafrim me *acquis* të Bashkimit Europian,
 - ii. Forcim i mbikëqyrjes prudenciale,
 - iii. Rritje e qëndrueshmërisë digjitale,
 - iv. Mbrojtje më e mirë e konsumatorit, dhe
 - v. Zhvillim më i thellë i tregjeve financiare jobankare.



PRORITETET NË VIJIM

Për vitin 2026 dhe periudhën në vijim, prioritetet e Autoritetit mbeten të lidhura me procesin e integritimit europian.

Prioriteti I

Përafrimi i kuadrit ligjor me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian.

Plani i veprimit në parashikimet aktuale përmban hartimin e rreth 30 akteve ligjore dhe nënligjore nga të cilat 15 janë ligje. Autoriteti ka përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për të paktën 7 nga këto ligje.

Prioriteti II

Zbatimi efektiv i reformave prudenciale, veçanërisht Solvency II dhe SNRF 17 të cilat do të ndryshojnë mënyrën se si vlerësohet kapitali, risku, raportimi financiar dhe qeverisja e shoqërive të sigurimit.

Prioriteti III

Modernizimi i infrastrukturës digjitale dhe forcimi i qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve kibernetike dhe teknologjike.

Prioriteti IV

Pjesëmarrja aktive në Programin e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), të organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Prioriteti V

Forcimi i masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit edhe në kuadër të bashkëpunimit me Komitetin MONEYVAL i Këshillit të Evropës.

AMF Mbledh në Tiranë Forumin Ndërkombëtar Mbi Rrezikun e Katastrofave Natyrore dhe Sigurimin si zgjidhje për mbulimin e tyre



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në Tiranë, Forumin Ndërkombëtar “Rreziku nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri dhe sigurimi si zgjidhje për mbulimin e tyre”, në bashkëpunim me AON Reinsurance dhe Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë. Forumi ishte një platformë diskutimi teknik e bashkëpunimi institucional me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të institucioneve partnere europiane dhe ekspertëve ndërkombëtarë nga industria globale e sigurimeve dhe risigurimeve, si edhe shoqëritë e sigurimeve në vend dhe institucione të tjera.

Panelistët e forumit ishin ekspertë të mirënjohur dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga institucione dhe organizata prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë AON, ANIA, ITAS, PADROM, Hannover Re, duke i dhënë forumit një dimension profesional dhe ndërkombëtar.

Diskutimet u përqendruan në rolin e sigurimit në adresimin e kostove në rritje që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe ngjarjet ekstreme klimatike, duke bashkuar në një platformë të përbashkët ekspertizën ndërkombëtare, institucionet publike dhe industrinë e sigurimeve. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme për forcimin e dialogut mbi mekanizmat e qëndrueshëm të mbrojtjes financiare përmes skemave të sigurimit. Ai gjithashtu pasqyroi angazhimin e Autoritetit për zhvillimin e tregut të sigurimit, rritjen e ndërgjegjësimit mbi rrezikun nga katastrofat natyrore, si dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.



Adela XHEMALI | Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

“Sigurimi duhet kuptuar jo vetëm si një produkt financiar, por si një investim, një mekanizëm besimi, një premtim për rikuperim dhe një shtyllë kyçe e qëndrueshmërisë financiare. Bashkëpunimi dhe koordinimi mbeten thelbësore për krijimin, zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të politikave rregullatore, që mundëson shpërndarjen e riskut në mënyrë të balancuar dhe të qëndrueshme ndërmjet familjeve, bizneseve, siguruesve, risiguruesve dhe qeverisë, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se asnjë aktor nuk mund të përballojë i vetëm këto rreziqe.”



Znj. Milva EKONOMI | Kryetare e Komisionit Parlamentar
për Ekonominë, Punësimin dhe Financat

“Qëllimi ynë duhet të jetë ndërtimi i një Shqipërie më të qëndrueshme, më të përgatitur dhe më të mbrojtur ndaj rreziqeve natyrore, ku qytetarët nuk mbeten vetëm përballë fatkeqësive, por ku shteti, tregu i sigurimeve dhe partnerët ndërkombëtarë bashkëpunojnë për të ndërtuar mekanizma realë mbrojtjeje dhe rikuperimi”



Znj. Delina IBRAHIMAJ | Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit

“Eshtë shumë e rëndësishme që të ngremë të gjithë mekanizmat e duhur, me qëllim që, aty ku mundemi, të parandalojmë dëmet, por mbi të gjitha, aty ku fatkeqësitë ndodhin, të mundohemi të jemi sa më të sigurt nga ana ekonomike dhe fiskale, me qëllim që ekonomia e vendit të ndikohet sa më pak nga këto fenomene, të cilat nuk janë në dorën tonë, pasi janë fatkeqësi natyrore.”



Z. Jan LISKA | Drejtues i zyrës lokale të AON
Reinsurance në Shqipëri

“Shqipëria kombinon riskun e lartë nga tërmetet me një nivel të ulët penetrimi të sigurimit. Edhe pse 95% e banesave nuk janë të siguruar, ekzistojnë mundësi për të rritur nivelin e penetrimin dhe për të siguruar që dëmet për qytetarët nga ngjarjet katastrofike të kompensohen, pa ndikuar në buxhetin e shtetit.”

AMF NXJERR PËR KONSULTIM PUBLIK PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 76/2023 ‘PËR FONDET E PENSIONIT PRIVAT’”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nxjerr për konsultim publik projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 76/2023 ‘Për fondet e pensionit privat’” Projektligji synon përafrimin e plotë të kuadrit rregullator vendas me kërkesat e Bashkimit Evropian.

> Lexo më shumë...

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE MBLEDH GRUPIN NDËRINSTITUCIONAL PËR AVANCIMIN E KAPITULLIT 9 TË INTEGRIMIT EVROPIAN



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në cilësinë e institucionit drejtues të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, organizoi një takim të Grupit Ndërinstitucional për Përgatitjen e Integrimit Evropian (GNPIE), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Zyrës së Kryenegociatores.

> Lexo më shumë...

AMF DISKUTON ME TREGUN PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 76/2023 ‘PËR FONDET E PENSIONIT PRIVAT’”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një takim me drejtues të shoqërive administruese të fondeve private të pensioneve, me fokus diskutimin e ndryshimeve të prishme në Ligjin nr. 76/2023 “Për fondet private të pensioneve”.

> Lexo më shumë...

AMF ZHVILLON TAKIM ME SHOQËRITË E SIGURIMIT PËR PËRGATITJEN E TREGUT DREJT REGJIMIT SOLVENCY II



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit, në kuadër të procesit të përafrimit të tregut shqiptar të sigurimeve me standardet e Bashkimit Evropian dhe kalimit gradual drejt regjimit Solvency II.

> Lexo më shumë...



26 qershor 2026

AUTORITETI PREZANTON PROJEKTRREGULLOREN PËR QËNDRUESHMËRINË OPERACIONALE DIGJITALE NË NJË TRYEZË GJITHËPËRFSHIRËSE TË PLATFORMËS SË PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Takimi shënoi një hap të rëndësishëm në forcimin e dialogut institucional me ekspertët, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e sektorit financiar jo-bankar si një mekanizëm të rëndësishëm institucional për komunikim, konsultim dhe transparencë gjatë procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

> Lexo më shumë...

18 maj 2026




SHQIPËRIA MERR PJESE NË TAKIMIN E 25 TË CESEE ISI NË VARSHAVË

Takimi mbledhi së bashku autoritetet mbikëqyrëse nga Evropa Qendrore, Lindore dhe Juglindore, me qëllim shkëmbimin e përvojave mbi çështje kyçe të mbikëqyrjes, përfshirë rrezikun nga katastrofat dhe ndryshimet klimatike, hendekun e mbrojtjes nga sigurimet, sistemet e pensioneve suplementare, rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në sektorin e sigurimeve, si dhe praktikën e risigurimit.

> Lexo më shumë...

12 maj 2026



AMF TAKIM ME KËSHILLTAREN E LARTË TË ZYRËS SË ASISTENCËS TEKNIKE NË DEPARTAMENTIN E THESARIT TË SHBA-SË, PAULA JONES – SIGURIA KIBERNETIKE DHE MBIKËQYRJA ME BAZË RREZIKUN, NË FOKUS

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Adela Xhemali, së bashku me përfaqësues të Autoritetit, zhvilloi një takim online me znj. Paula Jones, Këshilltare e Lartë pranë Zyrës së Asistencës Teknike në Departamentin e Thesarit të SHBA-së (OTA), e cila ka një eksperiencë të gjerë në reformimin e sektorit financiar, mbikëqyrjen bankare dhe forcimin e stabilitetit financiar.

> Lexo më shumë...

28 maj 2026



DREJTORESHA EKZEKUTIVE E AMF-SË ADELA XHEMALI MERR PJESE NË TRYEZËN “MBIKËQYRJA PARLAMENTARE SI INSTRUMENT PËR MIRËQEVERISJE DHE INTEGRIM NË BE”

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Adela Xhemali, mori pjesë në Tryezën e Dialogut me temë “Mbakëqyrja Parlamentare si Instrument për Mirëqeverisje dhe Integrim në BE”, organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Zvicrës dhe projektin ClusterOne Platform, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

> Lexo më shumë...

30 prill 2026



AMF NË STARTUP FORUM: KUADRI I RI RREGULLATOR DO TË MUNDËSOJË RITJEN E FINANCIMIT TË STARTUP-EVE DHE KAPITALIT SIPËRMARRËS NË SHQIPËRI

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po avancohet nismat për modernizimin e tregjeve financiare dhe përafrimin e tyre me standardet e Bashkimit Evropian, përmes një kuadri të ri rregullator që synon të nxisë zhvillimin e fondeve të kapitalit sipërmarrës dhe financimin e startup-eve në Shqipëri.

> Lexo më shumë...

29 prill 2026



AMF KONTRIBUON NË VLERËSIMIN E MONEYVAL PËR FORCIMIN E INTEGRITETIT FINANCIAR NË SHQIPËRI

Një mision nga Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, MONEYVAL, zhvilloi një vizitë në Shqipëri, ku në tryezat e diskutimit u prezantuan rezultatet e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

> Lexo më shumë...

23 prill 2026




INVESTIMET E GJELBRA NË FOKUS – DREJTORESHA E PËRGJITHSHME EKZEKUTIVE E AUTORITETIT, ADELA XHEMALI TAKIM ME PËRFAQËSUES TË LARTË TË BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), znj. Adela Xhemali, zhvilloi sot një takim me përfaqësues të lartë të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), një nga institucionet më të rëndësishme financiare të Bashkimit Evropian, e cila ka një rol kyç

> Lexo më shumë...

7 prill 2026



ZHVILLOHET TESTIMI I VLERËSUESVEVE TË DËMEVE NË SIGURIME

Më 7 prill 2026, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi testimin për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, me pjesëmarrjen e 20 kandidatëve. Ky proces, i realizuar në zbatim të Ligjit nr. 52/2024, synon të garantojë që në treg të ushtrorjën veprimtarinë vetëm profesionistë të kualifikuar, duke përmirësuar saktësinë, transparencën dhe paanshmërinë në trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përmes vlerësimit dhe licencimit, AMF kontribuon në rritjen e cilësisë së shërbimeve, mbrojtjen e konsumatorit dhe forcimin e besimit në tregun e sigurimeve.

18 qershor 2026



ZHVILLOHET SIMPOZIUMI “ANALIZA E AKSIDENTEVE, SIGURIA RRUGORE DHE SFIDAT E SIGURIMEVE”

Në datat 18–20 qershor 2026 u zhvillua në Tiranë Simpoziumi i Dytë Kombëtar “Analiza e Aksidenteve, Siguria Rrugore dhe Sfidat e Sigurimeve”, organizuar nga EVU-Albania, pjesë e Shoqatës Evropiane EVU, me pjesëmarrjen e ekspertëve të sigurimeve, studiuesve dhe profesionistëve nga Shqipëria dhe vende të tjera evropiane. Në këtë aktivitet, përfaqësuesit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare trajtuan kuadrin ligjor dhe rregullator të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transporthit, duke u ndaluar të llojet e sigurimit, risqet e siguruar, tarifimi, faktorët e riskut, trajtimi i dëmeve, limitet e përgjegjësisë dhe përafrimi me standardet evropiane.

AMF DHE GRUPI INTESA SANPAOLO DISKUTOJNË MUNDËSITË E REJA PËR ZHVILLIMIN E TREGUT FINANCIAR SHQIPTAR



Produktet e avancuara financiare dhe mundësitë e reja për zhvillimin e tregut shqiptar ishin në fokus të takimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me përfaqësues të Intesa Sanpaolo Bank Albania, Intesa Sanpaolo Group, Eurizon Asset Management dhe IMI Corporate & Investment Banking.

> Lexo më shumë...

AMF ZHVILLON TAKIM KONSULTUES ME TREGUN E SIGURIMEVE PËR DRAFTLIGJIN "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT"



Më 21 prill 2026, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një takim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë, nëpërmjet përfaqësuesve të shoqërive të sigurimit të jo-jetës, në kuadër të prezantimit të draftit të parë të projektligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

> Lexo më shumë...

AMF NXJERR PËR KONSULTIM PUBLIK PROJEKTRREGULLOREN "PËR QËNDRUESHMËRINË OPERACIONALE DIGJITALE NË SUBJEKTET E LICENCUARA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE"



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe angazhimeve që rrjedhin nga ky proces, ka hartuar projektregulloren "Për qëndrueshmërinë operationale digjitale në subjektet e licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare".

> Lexo më shumë...

AMF DHE IFC TAKIM PËR TË ARDHMEN E SHËRBIMEVE FINANCIARE DIGJITALE DHE ZHVILLIMIN E TREGJEVE INOVATIVE NË SHQIPËRI



Në kuadër të projektit të International Finance Corporation (IFC) "Shërbimet Financiare Digjitale" për Ballkanin Perëndimor, Zëvendësdrojtresha Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), znj. Merita Gurabardhi, së bashku me z. Aldion Baze, Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Regjistruara të Shpërndarë (DLT), zhvilluan një takim me përfaqësues të IFC-së.

> Lexo më shumë...



PRIMET BRUTO
TREGU TOTAL

+4.90%



PRIMET BRUTO
TREGU I JOJETËS

+4.89%



DËMET E PAGUARA
TREGU TOTAL

+15.86%



DËMET E PAGUARA
TREGU I JO-JETËS

+18.77%

Maj 2026-Maj 2025



PRIMET BRUTO
TË DETYRUESHME
MOTORIKE

+4.35%



PRIMET BRUTO
TREGU I JETËS

+5.50%



DËMET E PAGUARA
TË DETYRUESHME
MOTORIKE

+15.60%



DËMET E PAGUARA
JETË

+5.47%

TREGU I FONDEVE PRIVATE TË PENSIONEVE

RAPORTIM STATISTIKOR
Periudha: **Deri më 31 Dhjetor 2025**

31 Dhjetor 2025 - 31 Dhjetor 2024

 AKTIVET NETO
TOTALE

+16.94%

 NUMRI I
ANËTARËVE

+11.07%

 FONDET ME PJESË-
MARRJE TË HAPUR

+21.55%

TREGU I FONDEVE TË INVESTIMEVE

RAPORTIM STATISTIKOR
Periudha: **Deri më 31 Dhjetor 2025**

31 Dhjetor 2025 - 31 Dhjetor 2024

 AKTIVET NETO
TOTALE

+14.19%

 NUMRI I
INVESTITORËVE

+11.51%

 SEGMENTI ME
OFERTË PUBLIKE

+12.77%

Ankesat e konsumatorëve

Tremujori I 2026 | Tregu i sigurimeve

171

ankesa të depozituara


97%

lidhen me sigurimet


86.6%

zgjidhur pas ndërhyrjes

Ankesat sipas kategorisë



Zgjidhur pas ndërhyrjes së AMF



MASHTRIMET ME KRIPTO-ASETE: SI T'I DALLONI DHE TË MBROHENI.

FITIME TË GARANTUARA

1

Nëse ju premtohen fitime të larta, të shpejta ose pa rrezik, ky është një rast i dukshëm mashtrimi, pasi çdo investim mbart rrezik dhe mund të sjellë humbjen e një pjese ose të të gjithë shumës së investuar.

Kërkesat me insistim për të vepruar menjëherë (*Kape tani se iku!*), ofertat me afat shumë të kufizuar kohor përdoren shpesh për t'ju penguar të verifikoni ofertën. Mos merrni vendime përpara se ta shqyrtoni dhe ta verifikoni ofertën.

4

PRESION PËR TË VEPRUAR MENJËHERË

OFERTA TË PAKËRKUARA

2

Tregoni kujdes ndaj mesazheve, telefonatave ose ofertave për investim që ju vijnë papritur, veçanërisht kur kontaktoheni nga persona ose subjekte që nuk i njihni, përmes rrjeteve sociale apo kanaleve të ndryshme të komunikimit.

Asnjë subjekt i ligjshëm nuk i lejohet t'ju kërkojë me telefon, email, mesazh, rrjete sociale ose në internet, të dhëna si: password-e ose kodet e sigurisë apo çdo e dhënë tjetër që ndihmon në aksesimin e portofolit tuaj digjital apo llogarive të ndryshme.

5

KËRKESA PËR TË DHËNA KONFIDENCIALE

LINQE DHE APLIKACIONE TË DYSHIMTA

3

Mashtruesit mund të përdorin linke, kode Quick Response (QR) ose aplikacione të rreme për t'ju drejtuar në faqe të falsifikuara ose për të marrë akses në portofolin tuaj digjital. Mos klikoni, mos skanoni dhe mos shkarkoni asgjë nga burime të paverifikuara.

Faqet e rreme mund të duken profesionale dhe të përdorin logo, adresa interneti shumë të ngjashme me subjekte të njohura dhe të licencuara, të autorizuara ose të mbështetura nga institucione të njohura. Kontrolloni gjithmonë adresën e saktë të internetit (domain-et).

6

FAQE QË IMITOJNË SUBJEKTË TË NJOHURA

INFORMIM PËR PUBLIKUN

Çfarë është DORA?

Rregullorja Evropiane (BE 2022/2554) që forcon sigurinë dixhitale të shërbimeve financiare — së shpejti në Shqipëri.



Të dhëna të mbrojtura

Standarde më të larta të sigurisë dixhitale



Shërbime pa ndërprerje

Vijueshmëri e garantuar e shërbimeve financiare



Reagim i shpejtë

Incidentet raportohen e zgjidhen menjëherë

RISITË KRYESORE

Çfarë sjell të re DORA?



Kuadër i unifikuar

Rregulla të njëjta për sektorin financiar jo-bankar



Mbikëqyrje e re e TIK

Edhe shërbimet TIK e ofruara nga plaë të treta



Testime të avancuara

Simulime sulmesh (TLPT)




Raportim i standardizuar

Sipas rregullave të qarta

AFATET KRYESORE

Kur hyn në fuqi?



ZHVILLIME NDËRKOMBËTARE

Sigurimi kibernetik: Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) dhe IAIS publikuan studim të përbashkët

Evolucioni i shpejtë i kërcënimeve kibernetike i nxitur nga përparimet teknologjike, duke përfshirë inteligjencën artificiale (IA), tensionet në rritje gjeopolitike dhe natyra e ndërlidhur e ekosistemeve digjitale, po rrisin shpejtësinë, shkallën, sofistikimin dhe natyrën sistematike të incidenteve kibernetike. Në këtë sfond, sigurimi kibernetik ka potencialin për të mbështetur rezistencën kibernetike dhe për të zbutur humbjet financiare që rrjedhin nga incidentet kibernetike, aty ku është i siguruashëm. Pavarësisht rritjes së shpejtë të ekspozimit ndaj rrezikut kibernetik, mbulimi i sigurimeve kibernetike mbetet i kufizuar dhe tregu vazhdon të përballlet me sfida të rëndësishme që lidhen me paqartësinë e mbulimit, çmimet dhe rrezikun e akumulimit.

Ky studim i përbashkët i FSI dhe IAIS ofron një pasqyrë në kohë se si modelet e inteligjencës artificiale ndërkufitare mund të transformojnë ndjeshëm peizazhin e kërcënimit kibernetik dhe mbrojtjes, si dhe implikimet për tregun e sigurimeve kibernetike. Në veçanti, ai shqyrton mbulimin e produkteve të sigurimit kibernetik, çmimet dhe praktikatat e nënshkrimit, dhe eksploron boshllëkun e mbrojtjes së sigurimeve. Në studim jepen edhe konsideratat kryesore për mbështetjen e zhvillimit të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të sigurimit kibernetik.

[Lexo më shumë...](#)

Ndryshimet klimatike & Sigurimi si mbrojtje: Sfida e re për sektorin e sigurimeve

Ndryshimet klimatike përfaqësojnë një nga sfidat aktuale më të mëdha për sektorin e sigurimeve në Evropë. Përballë rritjes së frekuencës dhe intensitetit të fatkeqësive natyrore, zvogëlimi i hendekut të mbrojtjes mbetet një objektiv kyç i politikëbërësve dhe autoriteteve mbikëqyrëse. Sipas EIOPA-s, vetëm rreth 25% e humbjeve nga katastrofat natyrore në BE kanë qenë të siguruara gjatë dekadave të fundit, ndërsa vetëm 17% e qytetarëve deklarojnë se kanë mbulim për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Ndryshimet klimatike po ndikojnë gjithnjë e më shumë në tregjet e sigurimeve, ndërsa përmbytjet, zjarret, stuhitë dhe valët e të nxehitit po bëhen më të shpeshta dhe më intensive. Sipas EIOPA-s, kjo prirje mund të ndikojë në përballueshmërinë dhe disponueshmërinë e mbulimit të sigurimit në zonat më të ekspozuara, duke nxjerrë në pah nevojën për masa parandaluese dhe mekanizma më të avancuar të menaxhimit dhe ndarjes së rrezikut. Në këtë kontekst, siguresit pritet të forcojnë modelet e tyre të vlerësimit të rrezikut duke përdorur skenarë klimatikë, teknologji gjeohapësinore dhe inteligjencë artificiale, ndërsa politikatat publike dhe bashkëpunimi rajonal duhet të fokusohen në forcimin e qëndrueshmërisë, uljen e hendekut të mbrojtjes dhe nxitjen e investimeve në masa parandaluese. Mesazhi kryesor i EIOPA-s është i qartë: përshtatja ndaj rreziqeve klimatike nuk është më një zgjedhje, por një domosdoshmëri për stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e qytetarëve.

[Lexo më shumë...](#)

Më shumë se një Policë Sigurimi: Diskutimi Global me fokus Mbrojtjen Konsumatore

A po marrin konsumatorët vlerën që u premtojnë produktet e sigurimit? Kjo është pyetja që Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) ka vendosur në qendër të diskutimit global përmes publikimit të saj më të fundit: Konsumatori dhe vlera e përftuar nga sigurimi ("Customers Receiving Value from Insurance Products"). Nisma vjen në një kohë kur, pavarësisht rëndësisë së sigurimit për mbrojtjen financiare të individëve dhe bizneseve, shumë konsumatorë e kanë të vështirë të vlerësojnë nëse një produkt ofron përfitime të drejta, në raport me koston e tij. Sipas IAIS, kompleksiteti i kushteve kontraktuale, terminologjia teknike dhe natyra e vetë produktit krijojnë pengesa për gjykimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen nga konsumatori.

[Lexo më shumë...](#)